



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
MINISTRI

Nr. 4699 Prot.

Tiranë, më 30.04. 2019

URDHËR

Nr. 252, datë 30.04 2019

PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES
PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E
E DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 26 të ligjit nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, vendimit nr. 99, datë 27.02.2019 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.



MINISTËR

Besa Shahini
Besa SHAHINI